



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË MEDIAS "BBF-TV DHE GAZETA
PANORAMA" NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për miratimin e përfaqësuesve të Medias të paraqitur nga "BBF-TV dhe Gazeta Panorama" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor, 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

BBF-TV dhe Gazeta Panorama kanë paraqitur kërkesën e tyre përkatësisht me nr.prot 12107 të datës 21.06.2019 dhe nr.prot 12009 të datës 21.06.2019 bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 2 (dy) përfaqësuesve të BBF-TV dhe 14 (katërbëdhjetë) gazetarëve të gazetës "Panorama"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se dokumentacioni është i plotë por kërkesa e paraqitur nga BBF dhe Gazeta Panorama nuk respekton afatin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor.



Nr. 851 i Vendimit

Data 22 .06.2019

Ora 12 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e përfaqësuesve të paraqitur nga "BBF-TV dhe Gazeta Panorama" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e BBF-TV për akreditimin e 2 (dy) përfaqësuesve të saj, dhe Gazeta Panorama për akreditimin e 14 (katërmbëdhjetë) përfaqësuesve të saj për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjet Nr.4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 851 i Vendimit Data 22 .06.2019 Ora 12 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e përfaqësuesve të paraqitur nga "BBF-TV dhe Gazeta Panorama" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.